



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:063193

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03382362

P. nr.873/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve D. Gj. nga Gjakova, për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën. par.1.4 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së si dhe të akuzuarit D. Gj. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore—DP në Gjakovë, PP.nr.1338/18 të datës 03.12.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **30.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, te dëmtuarit N. H. dhe të akuzuarit D. Gj., me date 31.08.2022 te mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D. GJ. nga Gjakova**, . . . , data e lindjes . . . , i biri i D. dhe i nënës N. e gjinisë R., ka të kryer shkollën e mesme, i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas Republikës së Kosovës, me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

IV.

-se me datë 21.07.2018, rreth orës 00:30min në rrugën “. . . ” në Gjakovë, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit N. H., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake që kishte i pandehuri D. me të dëmtuarin P. të cilin edhe e godet, ashtu që gjatë përleshjes i pandehuri D. ndërhyr duke e goditur po ashtu të dëmtuarin N. me një mjet të fortë të cilën e nxjerr nga brezi, ashtu që e godet shpinë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, sipas akt ekspertizës mjeko ligjore të Dr..F. B.të dt. 09.10.2018.

-me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,43,49,50,51,73,74 të KPRK-ës, dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-së, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari N. H. nga fshati . . . , Komuna Gjakovë , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet e akuzuari që ti paguaj shpenzimet procedurale të paguaj shumën prej **20.00 €** (në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20.00 euro) si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej **30.00 €**, në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1338/18 të datës 03.12.2018, ndaj te akuzuarve D. Gj. nga Gjakova , për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën. par.1.4 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së si dhe të akuzuarit D. Gj. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. .

Gjykata ka caktuar shqyrtimet gjyqësore , në të cilat nuk ka marr pjesë i akuzuari D. Gj., ku sipas njoftimit nga Stacioni Policor në Gjakovë duke vepruar sipas Urdhëresës së Gjykatës, me parashtrësën me nr. Ref.04/1-08-Gj-S-27/20 jemi njoftuar se i akuzuari D. Gj. gjendet në Kanada , e këtë e ka konfirmuar prindi i tij D. Gj. me nr. tel. . . .

Gjykata për të akuzuarin D. Gj. me datën 27.01.2020, ka pezulluar procedurën në këtë çështje penale dhe për të akuzuarin D. Gj. ka lëshuar Urdhër arrest me numër P.nr.873/18.

Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës konstatoj se i akuzuari D. Gj., akuzohet për veprat penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën. par.1.4 të KPRK-së dhe veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, të kryer me datë 21.07.2018 e që prej asaj kohe e gjere me ditën e sotme kanë kaluar me shumë 4 (katër) vite, çka do të thotë se ka kaluar dyfishi i kohës se afatit të parashkrimit –ndalesa absolute mbi ndjekjen, konform nenit 107 par.8 lidhur me nenin 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së, dhe ndaj të akuzuarit nuk mund të ndërmerren kurrfarë veprimesh për ndjekje penale, andaj jashtë shqyrtimit gjyqësor me datën 22.08.2022 ka marr Aktvendimin P.nr. 873/18 , me të cilin Hedhet aktakuza dhe pushon procedura penale kundër të akuzuarit D. Gj. nga Gjakova ,për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale nga neni 107 par.8 lidhur me nenin106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së.dhe ka tërhequr Urdhër arrestin .

Gjatë shqyrtimit fillestar me datë 30.08.2022, Prokurori shtetit Anton Hasanaj lexon aktakuzën PP.nr.1338/18 të datës 03.12.2018, ç’ rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës sa i përket të akuzuarit D. Gj..

I akuzuari D. Gj., duke u deklaruar lidhur me fajësinë , thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer në afekt me qenë se siç kam deklaruar ditën kritike konflikti mes birit tim dhe te dëmtuarve nuk e di se për çfarë arsye ka filluar , por unë duke parë një situatë te tillë kam hy si ndërmjetësues dhe nuk jam i sigurt se a e kam goditur apo jo ne gjendjen ne

te cilën isha ,ku edhe i njëjti ka pësuar lëndime edhe nga ana ime , kërkoi falje nga te dëmtuarit për lëndimin të cilin e ka marr edhe pse me te njëjtit me par apo pas këtij rasti nuk kemi pasur probleme andaj, i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur ne gjykatë, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme, gjendje te dobët e ekonomike, te me shqiptojë një dënim me te butë.

I dëmtuara N. H., deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, sa i përket ndjekjes penale i le ne vlerësim gjykatës ndërsa kompensimin e demit do ta realizojë ne kontest civil.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë Prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari D. Gj. , pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e kanë bere ne mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë te sqaruara nga ana gjykatës, duke marr parasysh se aktakuza ka mbështetje ne provat personale dhe materiale ne bazë te cilave është paraqitur gjendja faktike ne dispozitiv ku edhe përmbushen te gjitha elementet e veprës penale me te cilën ngarkohet i akuzuari. I propozoi gjykatës që i njëjti të shpallen fajtor, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari D. Gj. : se me datë kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e dytë të këtij aktvendimi, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit N. H., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake që kishte i pandehuri D. me të dëmtuarin P. të cilin edhe e godet, ashtu që gjatë përleshjes i pandehuri D. ndërhyr duke e goditur po ashtu të dëmtuarin N. me një mjet të fortë të cilën e nxjerr nga brezi, ashtu që e godet shpinë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, sipas akt ekspertizës mjeko ligjore të Dr..F. B.të dt. 09.10.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimi nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve, i pa punë ,gjendjen e dobët ekonomike , pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar , sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga i dëmtuari për lëndimin që i ka shkaktuar, premtimi se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata

ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **6 (gjashtë)** muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, sanksion ky që sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 50 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin N. H. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike ,edhe pse i dëmtuari përmes telefonit është deklaruar se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej **20.00 €** (në emër të ekspertizës mjekësore) si dhe paushalli gjyqësor në shumë prej 300,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.873/18 më datë 31.08.2022**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.